-"Luftra të mëdha bëhen në këto anë,këto luftra bëhen pa pushim,në kushte jo të barabarta në forca njerëzore e municione." Këto luftra janë të tmerrshme dhe paraqesin rrezikshmëri të madhe dhe vdekja e çdo njërit nga ne është shumë afër. Kjo mund të jetë edhe vdekja ime. Por dhe nërastse ...jam krenar ,se ky është një detyrim,e obligim i imi për të cilin kam marrë guximin të futëm në luftë për një qëllim të madh!Nëqoftëse vdes më dënon padrejtësia e regjimit sërb,që për realizimin e masakrave nuk pyet asnjë,ai regjim mund të parandalohet vetëm me forcë dhe me pushkë.

Marshojnë ndaj nesh me mijëra pushkë e mijëra tanke të cilat pa mëshirë e urrejtje na sulmojnë në të gjitha anët,ditën e natën e pandërprerje.
Shumë shokë dhe bashkëluftëtarë të mijë kan rënë në fushën e luftës si trima dhe si u ka hije! ... Kjo është e mundër dhe shumë e dukshme që do të më përshëndes dhe mua!?...Për këtë do të jem krenar e mendjartë.Do më vij keq që ndoshta nuk do të shoh me sytë e mi Kosovën e lirë,për atë liri që do të qëndiset me pushkën time që vazhdon të këndoj më krenari dhe të shokëve të mi që nuk i shoh më në front të luftë.

Nënës Fatmire mi thuaj me guxim e forcë që ,për mu të mos mërzitet,të mos lëshoj asnjë pikë loti,bile të jetë shumë krenare se ka rrit një trim që nuk i trembet syri kurrë përpara tankut e topit armik.Po shkoj të takohem më shokët e mi që

luftuam së bashku dhe u deshëm shumë njëri me tjetrin.

Më ke kujdes babën,pasi ai të don shumë.I thuaj këtë fat e rrugë zgjodha vetë dhe ndoshta derdh gjakun,për vllezërit e mi Kosovarë.
E kjo do të bëhet në fushën e nderit ,në betejë dhe vëtëm në betejë.
Mua më lëndon zemrën,por më jep shumë fuqi në kushtet më të vështira, dashuria prindërore, dashuria vllazërore,
dashuria shoqërore e miqësore ,që i kam dashur aq shumë dhe më kanë dashur po aq shumë.
Mi thuaj në emrin tim se këtë dashuri dhe respekt që na mungon për moment,do t'ua shpërblej vetëm me nder e burrëri në front e në paqe nëse do jemi prap bashkë.

Trupat e tyre u tretën në vendin ku ato ranë,ishte e pa mundër që të bënin ndonjë zgjidhje tjetër,pasi lufta ishte në kulm ,sulmi ishte i fuqishëm nga të gjitha anët,luftë me armiku dhe luftë me vdekjen që ishte aq afër dhe e pranishme kudo. E tani doli detyra sa humane dhe oblikuese që në këto kushte fisnikët e lirisë të kalonin nga kafazi i lirisë në tribunën e lavdishme të historisë , së një lufte të re ,dhe të një lavdie që i dhuruan Kosovës këto fisnike madhështorë të një epoke të re për Kosovë të vjetër e të stërmundueshme për një shekull.

Ata e kanë vendin në piedestalin më të madh të lirisë,atje ku bota njerëzore do t'i nderojë dhe respektojë në çdo përvjetor për vëprimtarinë e tyre historike, heroizmin e

E kë vall!?...Një vend me plot histori,që lind kurdoherë trima e heronjë për këtë atdhe të mrekullueshëm!

Zoti nuk ka vendos kurrë,që për Kosovë të mos bjerë diell". Zëri i ndërgjegjes në momentet më të vështira e më të rrezikshme do ju lë mësazhin :--"Liria e popujve është si lule mali,që për tu rritur e hapur erë lirie, ka nevojë të vaditet pa reshtur me gjak të pastër fisnikërie"!...

-E pranvera erdhi.Plot dritë e diell. Idealet, urimet shpresat filluan të thinjen,një botë e trazuar në shpirtë e në zemrën time.

Ato hapin një fole ku të prehet dashuria,atje ku patriotizmi shkëlqën, në zemrën dhe mendjen time udhëtojnë urimet e mija që hapën plagë të pa shërueshme në çdo hapësirë të jetës kosovare.

Ku jeta shkëlqen me mirësitë dhe krenarinë e kombit e të familjes sonë të lavdishme!..

PO, Halit Coka!...

Visari i lirisë

Ja më në fund lufta mbaroi ,Kosova fitoi!.....Ajo i ngjan një shkretëtire të pa fund,e djegur ,e rrënuar dhe e mbuluar me një re të kuqe ,plot shpresë,plot optimizëm.

Kjo shkretëtirë nuk erdhi nga dora e zotit por nga dora misterioze e njerëzve të pa shpirtë e të udhëhequr po nga njerëz pa zemër ,pa llogjikë e pa ndjenja njerëzore.

Humbje e madhe njerëzore ,ekonomike ,humbje e madhe shprese e idealesh të larta,filluan t'i buzëqeshin Kosovës sapo dal nga lufta.

Një epokë e re dhe një obligim i madh del para tërë vendit, të rënët donin të respektoheshin nga shokët e bashkëluftëtarët që luftuan në një llogore dhe vdiqën në krah të njëri- tjetrit.

atdhedashurisë më të madhe që dhuruan gjën më të shtrejtë Jetën !....

Rivarrimi i heroit

Më 24 gusht 1999,Riza coka, njofton njerëzit e tij më të dashur,se është i ftuar nga komanda e UÇK,për të marrë pjesë në ceremoninë e organizuar që, panderolat e 34 ushtarëve të UÇK,do të kalonin nga vendi ku shkëlqeu heroizmi i tyre,në piedestalin madhështorë të heroizmit të kombit tonë.

Mbushet autobuzi, plot me njerëzit e dëshmorit të Kosovës dhe mori rrugën në drejtim të saj për të marrë pjesë në këtë ceremoni sa madhështore dhe rrespektive për visarin e lirisë së Kosovë ,djalit tonë më të nderuar ,më të

Në këto kushte mendja më gatuante lloj –lloj mendimesh,duke sjell në mendje një jetë plot luftë,plot sakrifica ,vështërsi e mundime të pa zakonta të njeriut tonë më të mirë e të mrekullueshëm!?...

Më dukej sikur po dëgjoi këngën e pushkës së Halitit,që akoma oshtima e saj nuk është shuar në këto anë e vende të bukura,plot vuajtje që i kanë ra në këtë kohë mbi supe!

E nga zëmra buron urimi :

-Të lumtë pushka ,o Halit Coka!...

Shikoj ato vende dhe në horizont më dukej Haliti,me pushkë mbi supe duke ecur krenar e plot shpresë.

E prap ,del urimi:

-Të lumtë pushka! Flaka e saj tu bëftë dritë në atë botë të qetë ku ti je!..

respektuar,që shkëlqeu me heroizëm dhe sot nuk e kemi në gjirin tonë.

Këto janë njerëzit më të afërt që para disa muajsh kishin qeshur ,gëzuar e kënduar me Halitin. E tani ai nuk ndodhet më në gjirin tonë,ai ndodhet larg shumë larg...

Atje ku prehen trimat,heronjtë e heshtur të kombit kosovar e të gjithë Shqipërisë.

Bashkë me zhurmën shurdhuese të autobuzit që rëndonte mbi rrugën e asfaltin e zi,fëtyra të vrejtura,sy të përlotur që kalonte mbi faqet tona!.....Heshtje !.....Heshtje!.....

Kalonin kilomëtra,fusha ,kodra e male,e bashkë me rrugën rëndohej akoma më shumë , gjendja jonë shpirtërore,sekondi na dukej sa një vit e më shumë!.....

Në fantazinë time hedhin valle llo-lloj mendimesh në thellësinë e tyre kishte vetëm mërzitëri,ngazëllim,dhimbje të pakufishme,

ku zemra me shumë vështirësi e përballon këtë rrugë sa të mundimshme e plot vuajtje shpirtërore!....

Makina vazhdon me shpejtësi duke kaluar atë rrugë të gjatë drejt Deçanit zonës operative të Dukagjinit.

Linim nga prapa, shtëpi të djegura e të shkatërruara, ara të dëmtuara e të mbushura plot me gëzhoja e plot me mbeturina të lëndëve plasëse ,me mina të plasura e të paplasura që ishin rrezikshmëri për jetën e banorëve të asaj ane. Çdo gjë dukej tamam si një gërmadhë, shkretëtirë e pafundme, pa jetë, më pak shpresë, shumë optimizëm!.....

-“Rënja e Halitit është humbje jo vetëm për ju por dhe për mua e për gjithë Kosovën. Uroj që të jetoni ju ,të jetoj gjithë Kosova për ta kujtuar e nderuar gjithëmonë,e brez pas brezi.Kosova do e ketë burim drite për të ngrohë zemrat e njerëzve të vuajtur”.

Ra një heshtje e plotë për momentin,përqafime në heshtje...Morëm rrugën e futemi në hotel për tu shlodhur dhe për të biseduar më qetë deë më afër më shokët e uçk që na pritën e na nderuan,me një rrespekt të madh të dhuruar nga njeriu ynë i nderuar.Vazhduam biseden, diskutime,me njëri- tjetrin gje r në orët e vona të natës e mezi prisnim që të dal drita e të shkonim e të merrnim pjesë në ceremoni madhështore të organizuar nga UÇK në respekt të të rënëve dhe për t’i futur ato në histori.

Lart dukeshin ato shtigje e plot llogore!? ...E mendoi, Atë, të shtirë në pritë duke hapur zjarr me vetëmohim kokën lartë si barrikadë e pa kalushmë përpara rrebesheve të mëdha.Të përfytyroj si mali i Zepës që i bën ball me buzëqeshje jetës.

Duken ato kulla ,fole të luftës,ku kalonte natën me shumë të ftohtë,me shokë ,duke qëndruar në errësirë të plotë e vigjilent,për ndonjë goditje të befasishme nga armiqtë e pabesë.

Dukeshin shkurre dhe më dukej sikur,aty është Haliti!..

Duke hapur zjarrë,ndaj autokolonave që marshonin pa ndërprerje e të mëdha në numër që kërkonin të merrnin jetë të pafajshme.

E me buzë në gaz e dorën lartë uroj:

_”Të lumtë pushka e lirisë ylli ynë!.

Zjarri i saj jetë për të gjallët e Kosovës!...e plot dritë për ju që na dhuruat lirinë e Kosovës me grykën e pushkës"!....

-Të lumtë pushka ,me të madhe duket sikur them!..

Makina vazhdonte rrugën me atë monotoninë e saj plot zhurmë e mendimt e mia hedhnin e hedhnin valle.

Jetonin e kuvendonin me Halitin,më dukej sikur qesh më të,sikur marrë një këngë patriotike,sikur kuvendoj e diskutoj me Të.Kur desha t'i bëj një pyetje e ta përqafoj,e ta pyes ku je, makina ndalon,zhurma e saj ndërpritet,ndërpritet dhe mendimi dhe ndahem nga bota e ëndërrave duke parë vehten pranë hotel "Pashtrikut" ku na pritnin eprorë të uçk.

Para nesh na del komandanti së bashku më një grup e kuadro të uçk,shokë ,komandantë e bashkëluftëtarë të Halitit.

Njeriut tonë të nderuar e të respektuar jo vetëm për ne, por dhe për të gjithë kuadrot ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe tani tërë popullit të Shqipërisë.

Të rënduar në paraqitje,të rëndë në mendime,drejtohet ndaj nesh dhe me zë të lartë komandanti na thotë:

-"Ju shoh të lodhur nga vujtja juaj shpirtërore, për djalin tuaj Halit Cokën ,por dhe nga rruga e gjatë.Në këtë gjendje të rëndë shpirtërore tuajn, për djalin tuaj, për shokun e llogores, bashkëluftëtarin tim në bëtëja madhështore, po ju them vetëm kaq:

Ceremonia do të bëhej në Gllogjan në rrafshin e Dukagjinit.

Drita doli .Dualëm nga hoteli.

Sapo dolëm kudo shohim lajmërime, spote, thirrje në çdo vend,ndërtesë mur e kudo.

Tridhjëtë e tre trima do të bëhej rivarrimi,të cilët ishin tretur në vendin ku ato ranë duke luftuar heroikishtë. Pra do të lënin frontin e luftës e do të shkonin në piedestalin e lavdisë,për tu futur në historinë e kombit tonë që prodhon gjithëmonë heronje...hëronje dhe vetëm heronjë!....Në mes tyre ishtë dhe djali ynë Halit Coka që bashkë me tërë Kosovën kishim ardhë për ta nderuar dhe ne, vllazëria,shoqëria e miqësia.

Apoteozë!.... e shekullit të njëzet !

Tridhjëtë e katër visar të futur në kafazin e nderit,të mbuluar me beze të kuqe mbi të cilin është flamur që shëndrit si yll në sfondin e dhimbjes së paparë.

Aty qëndronin eshtrat e tyre që u tretën në vendin ku ranë dhe në pamundësi për të bërë veprim tjetër për ato kushte sa të rënda e të vështira.Tridhjëtë e katër jetë të humbura.!..Tridhjëtë e katër kafaz që tronditnin mijëra zemra më dëshira të venitura.

E rëndë mbi të rëndat është se ato qëndronin në krah të shokëve të një llogorje,por që zoti i ndërtojë punët në këtë mënyrë që njëri hero e tjetri me zemër të thyer loton e vuan.

Por fati mori atë që mori dhe të tjerëve u errësohen sytë,mbushen me lot dhe ecin me

Të gjithë të brengosur në zëmër,me lot ndër sy,marrim guximin që ta këthejmë dhimbjen në forcë,të mbledhim vehten dhe të themi:

-“Më që tërë Kosova qan për ty,ne do të bëhemi të fortë e të themi:-“Lavdi…Lavdi”!!!!…

Drita sa po çli!

Njerëz të shumtë, gra, vajza, pleq e fëmijë grumbulloheshin në një rrugë të gjatë e merrnin rrugën në këmbë.Rruga sa vinte e mbushej plot e për plot,dhe sa më shumë rrugë aq më tëpër njerëzit bëheshin më të dëndur.

Ata lëviznin shumë ngadalë ,pa zhurmë ,me fëtyra të zymta,pa fjalë tamam si në një ditë kortezie të rëndë e të paparë ndonjë herë.

Ditë plot zi e mallëngjim! ….

Po nderohen e përcillen në banesën e fundit bijtë dhe bijat më të mirë ,trima e atdhtarë .

Në mes turmës që vazhdon të shtohej vëren njërez më lot ndër sy,nuse të reja të veshura me të zeza, gra të veshura me të zëza më fëmijë për dore që dhe ata qanin dhe nuk e dinin pse qanin.

Nëna me fëmijë të vëgjël të veshur me rroba ushtarake duke imituar baballarët që tani nuk janë më por përcillen për në vendin e nderit për tu prehur të qetë.

Gra e burra të moshuar ku lotët hidhnin rrëke për bijët e bijat që kan humbur në këtë luftë.

Pra dhimbje e madhe ,lotë që mbushin një det të tërë!…po përcjellin për në piedestalin e nderit bijët e bijat e tyre.

Ngjarje e rëndë….tronditën zemrat e kujtdo që jo vetëm për ata që marrin pjesë në këtë ceremoni por ,dhe atyre që ndodhen kudo larg shumë larg,kudo që ndodhet!….

vendi ku ti vrave vdekjen për të fituar pavdekësinë !? ...

Lotët tonë shkojnë lumë e bashkohen me lotët e mijëra kosovarëve për të formuar një det me lot,që do të kthehet në bojë për të shkruar historinë për ju visar të kombit!... Për ty Halit coka!...

Zemrat tona janë të brengosura,por dhe krenare,për një vepër të madhe që hyn në historinë e kombit.Prandaj nga zemra uroj që dheu të jetë i lehtë ,për të mbajtur të ngrohta zemrat tuaja që më nuk rrahin.Uroj për gjithë ju kosovarë që dhimbjen tuaj ta ktheni në forcë!...Të premtoj ,Halit Coka,mu në zemër të Kosovës,në këtë tribunë nderi,se ne do të ruajmë në zemër e në mendjet tona veprën tuaj,do ta

ngadalë më rëndë se bota që rëndon mbi to tamam si një ortek shpirtërorë.

Durimi arriti kulmin kur në krahët e Samiut dhe Imerit qëndronte trupi i vëllaut të tyre,por dhe trupi i vëllaut që lindi nga besa e tyre për të rënë në llogoren e trimërisë.

Në pritje të vargut të pafundëm të njerëzve që marshonin prej disa orësh,mu në një fushë të mbuluar më barë bëheshin homazhet e lamtumirës.Në një pedan kafazët ishin vendosur në dy rrjeshta ,të mbështjellura me beze të kuqe dhe mbi të vendosur nje flamur.Ata ishin vëndosur në një distancë të largët njëri nga tjetri,ku pran çdo kafazi të lavdisë të qëndronin njerëzit më të afërt e më të dashur të çdo njerit nga ata.

Këto kafaz ishin rrethuar në formën e shkronjës" U" nga shokët e bashkëluftëtarët e tyre,ku me armë ngjeshur e të shtërnguar fortë mbi gjoks.

Po në rrjështin e dytë ,në formë e" U" ishin rënditur të gjithë kuadrot, eprorët që drejtuan dhe udhëhoqën tërë këtë luftë të madhe e të lavdishme.

Në këndin djathtas ishte vendosur një tavolinë ku çdo kush mund të bënte dhe të jepte oblikimin e tij.

U afrova ngadalë,mora penën në dorë,shikova më mirënjohj "Librin e Nderit" për martirët e UÇK.Habi!....Brengë në zemër time!Kënaqësi që në librin e nderit të kombit futet djali ynë,vëllau ynë, miku ynë!?...Dhe fillova të shkruaj jo me penë,por vetëm me shpirtë e me zemër.

"I dashur Halit! Të them kështu se dua të të shohë të gjall!...Dua të dëgjoj fjalën tuaj të ëmbël.Dua të shikoj fëtyrën tuaj të qeshur e buzëqeshjen tuaj të ëmbël.

Kanë ardhur këtu e të qëndrojnë pranë ,njerëzit tuaj më të dashur.Kërkojnë të puthin e të përqafojnë.....por jo!....

Këtë nuk na e lejon ti ,o Halit coka,se trupin tënd e ke mbuluar me beze të kuqe e mbi të ke vendosur një shqiponjë.Pra flamurin e kombit.

Kemi ardhur e të qëndrojmë pranë për të hapur portën e historise , mbrenda saj të fut vepra jote e shkruar me grykën e pushkës,të fusin shokët e një llogorje që të bëjnë roje nderi.. Të fusin eprorët e nderuar që luftuan së bashku.Po të qedrojmë pranë kur ti po vjen nga Mazniku,

Në mesin e tyre qëndron dhe kafazi i trimërisë,i njeriut tonë të dashur.Është ai djal që rininë e tij e ndërpreu për humanizëm njerëzorë.Është ai trim që trimërinë e tij ja dhurojë lirisë,patriotizmit e atdhedashurisë.

Pra kam nderin që me ndërgjegje më të pastër të thërras me të madhe në zemër të Kosovës e gjithë këtij njerëzimi që kan ardhë të respektojnë kafazët e tyre dhe në emrin e kafazit tim personifikojë:

-"Halit coka në pavdekësi do të jetë kurdoherë, banderola e lirisë, e trimërisë, e atdhedashurisë, patriotozmit e krenarisë kombëtare".

Pas homazheve të pa fundme bëhet nisja për t'i nderuar e për t'i vendosur në kullën ë piedestalin e nderit kombëtar.

trasmetojmë brez pas brezi e do e kemi burim frymëzimi e nder të fisit e familjeve tona...

Sa hërë që të hapet e lexohet ky libër ta dijë dhe të mos e harroj kurrë Kosova,

se në themelet e lirisë,pavarësisë qëndron gjaku i një Shqiptari që e ka emrin Halit Coka nga Arni Kukës.

Lavdi UÇK!....Lavdi Halit Coka!...

Rroftë Kosova!.....

Mirëupafshim në Kosovë të lirë!...

Të gjithë bashkë në pavarësi e në Kosovën "RËPUBLIKË"!....

Dhe mora rrugën për të vazhduar homazhet,u futa në rrjeshtë duke ecur me melankolinë e një ceremonie të till.

Rrëgull, disipllinë shembullore, njerëzit marshonin e nderonin më dorë e përkulje me respekt ndaj tyre.

Pran Halitit erdhën të gjithë e në mënyrë të veçantë u nderuan me një dozë më të madhe pasi ishte i vetmi vullnetarë nga shqipëria.Ramush Haradinai,Komandant dhe epror direkt i tij. Ai shtërngoj fortë dorën Rizas, Cenit, Fatmires, Lazimes, Haqifit ë Hazbies dhe tha:--"Haliti ishtë ushtarë shembullor,trim legjendar i pamposhtur ndaj çdo rreziku dhe së bashku me vllezërit e mi dhanë jetën për lirinë e Kosovë.Më bëni një fotografi me këto njerëz të nderuar të Halit cokës dhe të ma jepni vetëm mua në dorë."Vazhdonin homazhet kalonin njerëz të pa fund dhe radha dukej sikur nuk përfundonte asnjëherë ,me orë të tera.

Diçka tragjike,dhimbje,qarje më dënesë,gra të veshura në të zeza,shihej pran kafazve fëmijë të vëgjël që qanin me dënesë pasi ishin të vegjël dhe nuk e kuptonin pse qanin,të tjerët, të veshur me rroba të improvizuara të uçk,qeshnin dhe e jepnin vehten si " trima"dhe shikonin me habi nënat që derdhnin lot dhe vetëm lot plot si një lum.

Pamje e rëndë ,një skenë e një tragjedie të madhe. Mijëra zamra të thyera...!

Mijëra njerëz përkuleshin më respekt ndaj kafazëve të lirisë që mbanin mbrënda ,dhjetra jetë të shuara,dhjetra ideale të tretura për mos arritjen e qëllimit të tyre të ndërprerë në rrugë!...

U ndërprenë ëndrrat për ta parë Kosovën të lirë,indipedente, të pavarur e Republikë!?

Aty me fjalimet e tyre do të jepet lamtumira e fundit që patriotizmi ,trimëria dhe heroizmi i tyre të derdhej në një lapidar të madh dhe më vonë të hidhej në bronz.

Ata u vendosën në katin e dytë të një ndërtese të rrjështuar në tre radhë ashtu si në vendin e homazheve.

Poshtë qëndronin udhëhqësit më të lartë të uçk,si dhe njerëzit e përsonalitetet më të lartë të asaj kohe të shtetit të Kosovës.

Kafazët qëndronin madhështorë të rrethuar me qindra e mijëra njerëz nga tërë Kosova..Për minuta të tërë ligjëruan njerëz e personalitete dhe familjarë të afërm të këtyre Panderolave .

Shfaqet dhe vendimi që këto njerëz të nderuar të shpalleshin :--“Dëshmorë të Atdheut”.

këtu në vendin tuaj duke dhënë jetën për lirinë tuaj të nderuar Kosovarë!...

Populli i Kosovës dhe i Lumës gjatë gjithë historisë kanë jetuar, punuar dhe luftuar së bashku në një llogore.

Populli i lumës me Ramadan Zaskocin, e i Kosovës me Hasan Prishtinën i shkaktuan krizën më të rëndë Perandorisë Osmane ....në lidhjen Shqipëtare të Prizerenit.

Populli i Lumës në ball dhe i Kosovës në prapavijë në luftën heroike për mbrojtjen e vendit më 1912 ,mbrenda 72 orësh jo vetëm i ndalën vrullin por dhe mbetën mbi trmbëdhjëtë mijë të vrarë në fushën e luftës në Kolesian të Kukësit.

Po ashtu në luftën e dytë botrore,forcat partizane çliruan tërë Kosovën dhe i dhuruan lirinë e

Në mes të ligjërimeve shpreheshin nderimet më të larta për këta visarë të mëdhenjë të Kosovës,për përjëtësimin veprës së tyre,jo vetëm në historinë e shkruar,por dhe duke pagezuar me këto emra vepra dhe institucione në tërë Kosovën.

Në këto kushte del në plan të parë,të çohet dëri në fund amaneti i tyre,për ruajtjen e lirisë së fituar me gjakun e këtyre trimave.

Ruajtja e pavarësisë e të teritorit të këtij vendi,për të mos rënë më në pasoja të tilla misterioze.

Këto u futën në histori duke hapur një faqe të re dhe plot lavdi .

Duke patur një mirënjohje të veçantë,për djalin tonë,Halit Coka,i u rezervua një kohë për të treguar se Halit Coka,i dha vehtes lavdinë në

kohë të vështira lufte,por lavdia e tij do të shkëlqej dhe në kohë paqe,do të ngroh edhe zemrat tona, së dhe ne jemi krenar për atë vepër plot humanizëm e plot nder për gjithë shqipërinë e nëpërmjet kësaj dhe për zemrat tona,të njerëzve të tij që i deshi aq shumë dhe këto e deshën deri në pafundësi,mori fjalën Lutfi Coka duke përshëndetur këtë grumbullim të madh njerëzish,në emër të familjes dhe të gjithë shqiptarëve,e nëpërmjet të tjerave ai tha:

“ I ndëruar popull vëlla i Kosovës !...

Do ti puthja të gjithë këto panderola,se kanë qënë shokë dhe bashkëluftëtarë të një llogorje me djalin tonë Halit Coka,por,

putha djalin tonë se Ai ka bërë rrugë më të gjatë,ka derdh djerës më shumë dhe një patriotizëm më të madh e ka ardhë për të luftuar,

- Nga thellësia e zemrës sime hapet një brengë,e nga thellësia e saj burojnë fuqishëm urimi:

--Lamtumirë o Halit Coka!.....

--Lamtumirë Kosovë!.....

--Në aktin tënd heroik do të burojë gjithmonë jetë!...-Liri! .... pavdekësi!...

- I lehtë qoftë dheu që ushqen një lule shqiptare!...

Një trim,një hero e një atdhetar shembullor!...

humur.Tani jam krenar që popullin e lumës dhe të gjithë Shqipërisë,përfaqësohen nga tre trima,te fisit tim,Sami ,Imer dhe Halit Coka.

Luftuan me muaj të tërë bashkë më vëllezërit e motrat që ndodhen këtu në mesin tonë .

E më në fund Halit Coka me tre prill ra në fushën e luftës për të mos vdekur kurrë!

Duke i uruar Halit Cokës përjetësinë zemrat tona ,dhe në zemrat tuaja i nderuar popull i Kosovës,në emër të familjes së dëshmorit,uroj që gjaku i tij dhe i gjithë këtyre visarëve të shkojë për lirinë,pavarsinë e republikën e Kosovës ,dhe aq më shumë le të shkoj për bashkimin e kombit në një shqipëri të vetme etnike”!.... Një gjuhë,një komb,një shtet.

Sapo u ula nga tribuna e lavdisë dhe e nderimit të tyre ,u ula ngadalë dhe kur i dhash dorën Agim Çekut

Shef i shtabit të ushtërisë çlirimtare të Kosovës,më shërngoj dorën fortë ,më përqafoj dhe me zë të lartë që ta dëgjonin të tjerët më tha:

--"Të lumtë zotëri i ndëruar!...Dy hërë e nderove Kosovën në këto ditë të vështira.

--Në ditët e tmerrshme të luftës i dhuroi gjakun,djali juaj,Halit Coka.

-- Fjala jote bëri që zemrat plot dhimbje të këtij kortezhi të duartrokasin me shumë forcë".

Dhe më në fund pas tetë orë homazhe,respekt, dhimbje e nderime erdhi momenit që të ulen poshtë....që kafazët e lavdisë kombëtare të futen në dhomën e përjetësisë e historisë së kombit tonë!....

Nën breshërinë e pushkëve dhe kumbimin e topave,u rreshtuan,duke gëdhendur emrin me shkronja ari në pedanin e heronjëve të heshtur dhe yjeve të pashuar të Atdheut tonë. Mburoja,e lavdisë së tyre qëndron:

- Ai lapidar i ndërtuar me kurmin e trupit të tyre!...

--I ndërtuar me lavdinë e luftës së tyre!....

-Me atdhetarinë e idealit të tyre!...

-I ndërtuar me heroizmin e tyre.....E kur them këto....janë të pranishme edhe për ty, o Halit Coka ,bile dhe pak më shumë se kaq te takon Ty!.....Bashkë me shuarjen ë krismave të armëve u lajmërua përjetësia e tyre,ato prehen të qetë.

e ne të qetë e plot dhimbje largohemi.....duk mbajtur kokën prapa! .....

E mendojmë!...

Jetë e shkurtër plot lavdi

Më falni për mangësitë,por mendoj se me gjithë lexuesit do të mund të hedhim dritë mbi veprimtarinë e dëshmorit.Do ta sjellim në mend e të bashkëbisedojmë me Të, si ato ditë kur pinim kafe dhe këndonim e qeshnim me të dhe ai na buzëqeshte e bëntë shaka me ne të gjithë. Ja ku e kemi shtatoren që është vënë pranë kësaj shkollë.

Dhë bën sa më shumë dritë.

Kosova jetoi në ato vite si një lum i trazuar.Halit coka me dy kushërinjtë dhe trimat

dhurojë natyra,në trup në shpirtë Halit Coka. Halit Coka ishte i gjatë në trup dhe i lartë në mendje.

Ai u gatua me endrrën e zjarrtë dhe shpirtit të lirisë Kosovare. Heronjtë dhe dëshmorët e Kosovës i dhanë Halit Cokës,Portretin e përkryer të një luftëtari të kohës,portretin e trimërisë që mori dhenë e përfshiu tërë Kosovën.

Ai me kushërinjtë dhe shokët Kosovarë,latrësuan trimërinë sa një mal i lartë por dhe malet sa do të lartë të jenë ,kan përsëri maja më të lartë se rëtë, njëra nga këto maja është Halit Coka, që këtë lartësi ja dhanë liria e drejtësia në Kosovë. Në beteja legjendare,Haliti,i tha plumbit të sërbit :-nuk më vret dot!..

I tha topit ,-plaç!

e Kosovës i vunë vehtes detyrë që këtë vullkan që ziente të lëviste,të dilte në sipërfaqe,të shpërthente zjarrë dhe të digjte ato që i mundonin kaq shumë në mënyrë çnjerzore; të këpuste prangat e një shekulli robërie dhe t'i sillte Kosovës të shumëvujtur lirinë aq të dëshiruar dhe për të cilën ranë aq shumë heronjë.Kush u vranë aq shumë për të sjëel lirinë e humbur sa Kosova?!

Kush lëngoi më shumë ndër vite nën prangat e shtypjes, sa Kosova!?..

Në ç'vënd të botës u mbulua vendi me varreza masive, sa në Kosovë!?.

Bijat dhe bijtë e Kosovës drdhën gjakun lum ,në trojet e veta,e bashkë me ta dhe Halit Coka bir i Shqipërisë por në vendin e quajtur ,Kosovës.

Jetë plot lavdi

Në Kosovë, në vëndin ku luftoi Halit Coka,çdo prag shtepie është larë me gjak e me lumenjë loti që delnin nga trupat dhe sytë e njerëzve të pafajshëm!....Kosovarëve u është dashur shumë trimëri ,ndërsa Halit cokës i janë dashur mbi shtatë zemra ,për të zbrapsur këtë armik,sa të egër aq dhe shëkullor,të cilët e kanë mbajtur mbi qafën e Kosovës litarin e gjatë!....

Halit Coka lindi më 24 korrik 1974,ë bë flamur dhe më vonë u shëndërrue në hero për Kosovën.

Ai u shfaq si një yll që flakëroi dh vazhdon të lëshojë dritë kudo në Kosovën e djegur e të coptuar në trup e në shpirtë. Fuqinë morale,forcën fizike, shkathtësinë ezhdërvjelltësinë, trimërinë, zemrën e madhe, etjen e pa shuar për liri.--Të gjitha këto t'i

Naim Avdiu (dëshmorë)

Esat Lata

Shkëlzen Brahima(dëshmor)

Haxhi Sejdia

Dërvish Tahiri Brigada 134,"Bedri Shala"

VISARI I PATRIOTIZMIT MODERN

Kosova ka qënë vendi me luftra të pandërprera, ka përballuar stuhi e agresione të panumërta.Në këto kushte në Kosovë kanë lindur trima, luftëtarë, dëshmorë e patriot,heronjë e komandant legjendar.Veprimtaria heroike e burrave të Kosovës ,lindi në luftë dhe vetëm në luftë,sa herë armiku është futur në vend,kur ka filluar të plaçkis,të vras e të masakrojë njerëzit e pafajshëm.

Në këto kushte të vështira ishte domosdoshmëri që ky popull të mbrohej nga dikush. Heroizmi i

Prandaj nder dhe plot lavdi për jetë,epror i UÇK. Halit Coka!?.....

Mazniku



Atje në Maznik
Mbi një pllakë mermer,
Është shkruar ,një emër
Emër, plot nder!.
Mbi këtë pllakë
Është vënë buçëtë,
Këtu është shuar një ndërr,..
Është shuar një jetë!..
Është shuar ëndërra
Ë lirë Kosova,
Këtu ka rënë trimi,

Hero , Halit Coka!....
Kjo jetë u nda
Në kulmin e rinisë,
Që Kosova të këtë
Festën e lirisë..
Emri yt në lapidar
Po shëndrit porsi ar..
Gjer në qiell çon lavdinë,
Ë për ne krenarinë..!

Tre deshmore ne nje dite

Në Maznik në zemër t'Kosovës
Është vu pllakë mermeri,
Ëmër shkruar Halit Coka,
Lulë mali ,lul nderi.
Po aty një pllakë tjetër
Ë ka emrin Kujtim Ajdini,

Ë ma larg në veri,
Shkëmbëjnë nder e lavdi!!

Pra tri pllaka me shkronjë ari
Në fushë të Kosovës sollën Lirinë,
Presin të shkojnë te lapidari,
Që në shekuj të lëshojnë dritë!.

HALIT COKA
Zëqir Haxhiu "Kanuni"
Ismët Ahmëti

--Heroizmin e pashembullt,për të mbrojtur,të masakruarit nga barbaria shekullore që mbiu në zemër të Kosovës.

-Nacionalizmin demokratik,për njerëzit që vuajnë nga turturat misterioze e të papara..

-Atdhetarizëm e patriotizëm shembullor gjer atje ku ka këmbë Shqiptari dhe merr sa do pak frymë atje ku jeton.

Jeta e dhuruar nga Haliti,si gjëja më e shtrejtë dhe e pazevendsueshme, në vendin ku ai nuk ka lindur,por atje ku kan lindur e luftuar heronjtë më me zë të Kosovës.

- Heroizmi i Halit Cokës, pushon nën hijen e shpatës së Millosh Kopilit ,që hodhi në tokë kokën e Sulltan Mehmetit....

--Heroizmi i Halit Cokës pushon në gjoksin e Mic Sokolit,që i vuri gjoksin topit të turkut.

burrave të Kosovës lindi nga sulmi direkt i armiqëve të tij,pamundësia për t'ju shmangur këtyre masakrave,prodhuan trima e heronjë për të përballuar situatën në këto kohë të vështira.Humanizmi i këtyre trimave lindi si rezultat për mbrojtjen e nderit, dinjitetin të njerëzve të tyre më të afërt të gjakut,fshatit apo krahinës,nga pushtuesi,që kërkonte të vriste plaçkiste e të masakronte njerëzit e pafajshëm.

Atdhetarizmi e patriotizmi i tyre lindi si rezultat i bashkimit të popullit

për t'i bërë ball sulmeve gjakatare të armiqëve,për të ruajtur territorin dhe njerëzit e tyre në këto kushte tëpër të vështira.

Në vendin tënd çdo gjë të bukur ,-je i detyruar ta shijosh me kënaqësi të madhe.

-Çdo gjë të keqe ,je i detyruar ta përballosh sa do e vështirë që të jetë ajo.

- Çdo sulm sa do barbarë që të jetë ndaj vëndit ë njerëzve të tu, je i detyruar ta përballosh me çdo çmim.

-Atë vënd ku të ka ra koka ,je i detyruar ta duash dhe ta mbrosh me çdo kusht.

Duke analizuar sa më lartë,ai që gjykon,mendon,arsyeton, del në pah se heroizmi,humanizmi,patriotizmi i Halit Cokës ,ka diçka të veçantë nga këto cilësi të burrave të Kosovës.Baza e këtyre cilësive tek Halit Coka është vullnetarizmi,ndjenja e thellë që buronte nga shpirti i tij sa human aq dhe patriot!..

E për këto cilësi Halit cokës i takon shumë, më tepër,për t'i lartësuar sejcilën prej tyre dhe,edhe

këto përcaktime të miat nuk mjaftojnë për t'i plotësuar sa duhet.

- Humanizmi më ideal i takon , vetëm Halit Cokës..

-Trim mbi trimat , është Haliti.

-Patriot dhe atdhetarë,qëndron më lartë HALITI..

--Hero dhe më kryelartë është , Haliti!

Këto cilësi burrërore nuk ia dhuroi askush,nuk ia imponojë as vendi se nuk jetonte në Kosovë,as sulmet armike se ishte larg tyre,as lufta për tu vetëmbrojtur,pasi nuk ekzistontë një mundësi e till,por ndjenja e thellë që buronte nga zëri i ndërgjegjes,nga thellësia e shpirtit luftarak shpalosi:

-Humanizëm të thellë, për njerëzit e pambrojtur.

-Heroizmi i Halit Cokës rrezaton dritë në majën e lisit të Sef Koshares,të varura nga forcat turke..

--Pushon afër Hasan Prishtinës,dëgjon zërin e Shote e Azem Galicës.

Më në fund heroizmi i Halit Cokës lindi mbi gjoksin e vendosur tankut,që si një egërsirë e tërbuar kërkonte të shtypte trimin që se mposhtë as tërmeti më i fuqishëm.

Po,heroizmi i Halit Cokës u largua nga transheja për tu bashkuar me heroizmin e Adem Jasharit,dhe me heroizmin e pësëdhjëtë e gjashtë trimavë të kullës së" Jasharajve".

Në këtë kullë buroi trimëria ,heroizmi.

Në këtë kullë e ka folenë liria Kosovës e këtu ,në këtë kullë ,pushon dhe heroizmi i Halit Cokës.

Pushka e Halitit ishte pushka e dytë ,pas pushkës së "Jasharëve"

Një nderim më i veçantë.

E nëqoftëse ka ndonjë piramidë e ndërtuar me burra dhe heronjë e Kosovës,një vend me rëndësi kulmi i sajë, i takon djalit nga shqipëria,vullnetarit humanist, patriotit shembullor, nacionalistit demokratik Halit Riza COKA. Veprimtaria dhe lufta e pa epur e Haliitt ,në trojet e Kosovës,lartëson më shumë së kurrë,një heroizëm që kalon kufirin e atdhetarisë duke qëndruar patriot më i madh,nacionalist modern i kohës,humanistë shembullor i shekullit modern,një trimëri e rrallë e gërshetuar me zgjuarësinë bëri që trimëria të shkëlqejë fort dhe vetëm fort!.....Vendosmëria e patundër,iniciativa e madhe për ideale të larta njerëzore e shumë të rralla që ndodhin po rrallë, e bën që Halit Coka

E lavdishme e krenare do të jetë Kosova,me njerëz e trima të tillë si Halit Coka që u fut në kauzën e trimave më të mëdhenjë të Kosovës martire.

E prehet së bashku me ta në përjetësinë e nderit të kombit Shqiptar.

Nuk ka as psikolog që të shpjegojë dhe të zbërthej cilësitë e karakterit të Halitit.Në një moshë kaq të re,me prekupacione,që mund të ketë çdo i ri ,të triumfoj në ndërgjegjen e tij ,humanizmi njerëzor,mbi dëshirat dhe aspiratat që mund të ketë një moshë të tillë!?

Humanizmi i tij lindi si nevojë shpirtërore për të parë njerëz të qeshur e të gëzuar,pa lot ndër sy,pa brenga në shpirtë,pa dhimbje e fatkeqësi,prandaj zgjodhi pushkën,për të luftuar antihumanizmin

që podhonte dhimbje ,lot,gjak e varre masive në Kosovën martire.

Ndonëse heronjtë e Kosovës u gjendën përballë situatave sa të vështira aq dhe të domosdoshme,ishin të detyruar që të përballonin me luftë e gjak situata të tilla,ndërsa Halit Coka jashtë çdo rreziku të till,e quajti obligim dhe mori vendim sa historik aq dhe patriotik për të luftuar në krah të popullit të Kosovës.Këtu qëndon maja më e lartë e heroizmit, patriotizmit, nacionalizmit dhe e atdhetarizmit të Halit Cokës, që populli i Kosovës është më mirënjohës se bijve të tyre,pasi ky ka bërë rrugë më të gjatë në kushte të vështira shpirtëror ,e klimaterike, luftoi me vetëmohim deri sa dhuroi dhe jetën për Kosovën. Një obligim më shumë! ....

të jetë një hero i kompletuar,me veti të rralla,që shkëlqyen në front të luftës plot zjarr,që i dhanë Kosovës Lirinë, pavarsinë dhe shkëlqimin historik në një shekull të ri.Akti sublim i Halit Cokës nuk buroj nga ambjenti ku jetoi e punoi.Nuk pati në vendin e tij njerëz që derdhnin lot,nuk pati në vendin e tij fëmijë,gra ,burra e pleq ,apo varre massive.

Ato ,Haliti, i pa larg!.....shumë larg!.....në Kosovë në gjymtyrën e trupit tonë ndarë prej më se një shekull nga trupi ynë i helmuar!Mori rrugë të gjatë e me pushkë në dorë luftoi për të mbrojtur jetë të pafajshme,për të tharë lotët që rridhnin pa fund nga sytë e pafajshëm,për të mos patur më vorreza masive.

Që Kosovarët të gëzojnë,qeshin,e të shijojnë të ardhmen me plot optimizëm,me plot endrra të

mira e të gëzushme.Shumë u thanë , por duhet një roman që të shkruaj një jetë të shkurtër me heroizëm kaq të madh.

Ky hero i Kosovës e ka emrin HALIT COKA!

Kushtuar Halit Riza Coka

Punova më zemër e shpirtë,për të skalitur në mendjen tonë,ju Halit Coka!.Dhe kur

njeriu të vlerson e të don,ka shumë vështirësi të përshkruaj atë që din dhe ndjen për një personazh të tillë me vyrtyte të tilla. E pra unë dhash jo atë që ti pate, por një mundësi për tu futur në memorjen tonë një figurë që nuk do harrohet kurrë.

LUTFI COKA:Ka mbaruar shkollën e mesme pedagogjike dhe fakultetin për Matematik e Fizik. Ka punuar si mësues dhe drejtor i shkollës së mesme për vite të tëra.